



Njoftim për shtyp

Alpha Bank Albania mbështet edicionin e tretë të Festivalit Ndërkombëtar të Kitarës.

Fondacioni “Guitar Foundation of Albania”, në bashkëpunim me Universitetin e Arteve në Tiranë zhvilluan edicionin e tretë të Festivalit Ndërkombëtar të Kitarës, me mbështetjen e Alpha Bank Albania si sponsor gjeneral. Ky event është një nga takimet më të rëndësishme në jetën kulturore të kryeqytetit shqiptar, duke i ofruar publikut performanca të shkëlqyera artistike nga artistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Pjesëmarrës në këtë event ishin Ambasadori Gjerman në Shqipëri, Sh.T. z. Hellmut Hofman, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri; z. Periklis Drougkas, Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania; znj. Anke Holstein, zëvendësambasadore e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri; z. Konstantinos Piperigos, zëvendësambasador i Greqisë në Shqipëri etj.

Festivali, i cili u prit ngrohtësisht nga publiku, zgjati për tri ditë, nga 29 shtator deri më 1 tetor. Tri netët e këtij eventi sollën muzikantë të spikatur nga shtete të ndryshme, si Zvicra, Brazili, Gjermania, Suedia, Kanadaja, Australia etj.

Nëpërmjet këtij festivali, që komunikon vlerat universale të muzikës, Alpha Bank Albania theksoi përsëri rëndësinë dhe vëmendjen që Banka i kushton artit, kulturës dhe muzikës në vend, duke sjellë një aktivitet artistik të veçantë në kryeqytet.

Alpha Bank Albania është pjesë e Grupit Alpha Bank, themeluar që prej vitit 1879 dhe është një nga bankat dhe grupet financiare kryesore në Greqi, duke i ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, individëve, SME-ve, korporatave, nëpërmjet kartave të kreditit, drejtimit të aktiveve, veprimtarive bankare të investimit, veprimtarive bankare vetjake, veprimtarive të ndërmjetësit, leasing dhe factoring, etj. Alpha Bank është gjithashtu aktive në tregun ndërkombëtar bankar, me prani në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Shqipëri, Ish-RJ e Maqedonisë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

